



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

Date.04.10.2018

SHTOJCË

MBI MODIFIKIMIN DHE NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE STANDARTE TË TENDERIT

Sot më datë **04.10.2018**, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Në bazë të Nenit 42, të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) , procedura e Hapur e prokurimit me : REF-87798-09-28-2018 , me objekt: “**Ndërtim dhe Riparime rrugësh në Bashkinë Klos**”, me fond limit: **6.786.667** lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë **Klos** për vitin 2018,

Njësia e Prokurimit, vendosi te bëjë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit me objekt : **Ndërtim dhe Riparime rrugësh në Bashkinë Klos**”, si më poshtë vijon:

1. Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik pika **2.3.1/a**.

ISHTE:

Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

N.P – 1A (Punime gërmimi në tokë)

N.P – 4A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pistaeroportuale)

N.P – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

N.S – 1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)

N.S – 6 A (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese)

N.S – 7 A (Barriera dhe mbrojtje rrugore)

N.S – 18A (Punime topogjeodezike)

N.S – 19A (Sistemet kundra zhurmes per infrastructure)

BËHET

Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

N.P – 1A (Punime gërmimi në tokë)

N.P – 4A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pistaeroportuale)

N.S – 1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)

N.S – 7 A (Barriera dhe mbrojtje rrugore)

N.S – 18A (Punime topogjeodezike)

2. Në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, **Hiqet**

- **1 (një) inxhinier Hidroteknik...**

3. Në pikën 7 të kapacitetit teknik

ISHTE:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- 2 (dy) Hidraulik
- 2 (dy) Elektriçistë
- 1 (një) Saldatorë
- 1 (një) Mekanik
- 2 (dy) Teknik Ndërtimi
- 1 (një) Hekurkthyes
- 1 (një) Murator
- 1 (një) Manovrator
- 3 (tre) Shofera

BËHET

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- 2 (dy) Teknik Ndërtimi
- 1 (një) Hekurkthyes
- 1 (një) Murator
- 1 (një) Manovrator
- 3 (tre) Shofera

4. Në pikën 2.3.1 paragrafi fundit të kapacitetit teknik,

ISHTE:

Kandidati ofertues duhet të percaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i Shoqërisë)

Drejtuësin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në leqensën shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera **dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt**, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

Librezë pune (përkatëse)

CV përkatëse

Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

Diplomë

BËHET

Kandidati ofertues duhet të percaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i Shoqërisë)

Drejtuësin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në leqensën shoqërisë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

5.Në pikën 2.3.5 paragrafi i fundit të kapacitetit teknik,
HIQET:

Operatorët ekonomik duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin certificate ISO 9001-2015, ISO 14001-2015, PAS 99:2012 për prodhimin (ose kontratë furnizimi) e materialeve që do perdoren në ndërtimin e objektit ku minimalisht të përfshihen:

- Inerte
- Betone

NË SHTOJCËN 11 TË DT

ISHTE:

Operatori ekonomik nuk është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP-së, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.

BËHET

vetëdeklarim nga operatoriekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit, sipas nenit 26/8/d të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014.

Ju lutemi operatorëve ekonomikë që do të paraqesin ofertat e tyre për këtë procedurë të marrin për bazë Shtojcën mbi modifikimin dhe ndryshimin e Dokumentave Standarte të Tenderit në platformen elektronike të APP –së.

Sa më sipër Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2 dhe pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, vendosi të bëjë ndryshimet në dokumentat e tenderit përmes hartimit të një shtojce e cila u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.

Nisur nga ky fakt, Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, vendosi të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 (pesë) ditë kalendarike.

Njësia e Prokurimit njofton të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: “**Ndërtim dhe Riparime rrugësh në Bashkinë Klos**”, është si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 17.10.2018, Ora: 10:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 17.10.2018, Ora: 10:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, www.app.gov.al

Njesia e prokurimit

